



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E OBILIQIT / OPŠTINA OBILIĆ / MUNICIPALITY OF OBILIQ
Drejtoria e Planifikimit Urban, Pronës dhe Kadastrit

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OBILIQ
Nr. Br. No. 05-052-01-29227-24
Nr. i fq. / Br. str. / No. pg. _____
Data / Datum / Date 25.09.2024
OBILIQ - OBILIĆ - OBILIC



Raporti mbi shqyrtimin e ankesave nga Komisioni I Komunës mbi dokumentin e Hartës Zonale të Komunës së Obiliqit 2024-2032 të caktuar nga kryetari Komunës me Vendimin 02-020/01-23293/24

Nr.	Emri	Kërkesa	Ankesa	Vërejtje	Përgjegjja nga Komisioni I ankesave
1	Bekim Rama	Kërkesë për zonën kadastrale Obiliq, të ndryshohet zona e përcaktuar ZK-3 në zonë ZSHP-4	Ankesë për ndërrim të destinimit	Destinimi I parcelave tona që ndodhen në kuadër të Zonës Komerciale ZK-3 të parapara me me HZK- nuk përputhen me gjendjen faktike, pasi aty është zonë banimi kështu që kërkojmë që t'i jepet destinimi sipas gjendjes faktike	Kërkesa miratohet, grupi punues ka marr parasysh rrethanat e krijuara dhe gjendjen faktike ku është një mospërputhje në mes terrenit dhe dokumentit të HZK-së, prandaj grupi punues ka vendosur që këtë zonë të parashihet si zonë me shfrytëzim të përzier, pasi edhe gjendja faktike në teren është e tillë dhe nga ZK-3 ta shëndërrojnë në ZSHP-3
2	KEK-SHA	Kërkesë për përfshirje në HZK të "Solar4 Kosovo I-Photovoltaics"	Ankesë që nuk është përfshirë Projekti "Solar4 Kosovo I-Photovoltaics" në draft dokumentin e HZK-së	Parku solar eshte interes I pergjithshëm prandaj duhet të merret parasysh ky fakt	Me Projekt HZK, zona per te cilen eshte parashtruar kerkresa eshte e planifikuar per park solar.
3	Enver Gashi	Kërkesë për plotësim dhe ndryshim të destinimit të hapësirës me Kodin ZSHP-2-E	Ankesë që nuk është specifikuar shfrytëzimi i zonës me Kodin ZSHP-2-E	Të theksohet mundësia që në rast se nuk shfrytëzohet kjo hapësirë për ndërtim parkut solar e njëjta të mund të shfrytëzohet për ndërtim siq është e destinuar Zonë me shfrytëzim të përzier përkatësisht në pikën 4.1 të pjesës tekstuale në tabelën nr.10-Lista e zonave të destinuara sipas kushteve zhvillimore dhe në të cilën Hapësira me Kodin ZSHP-2-E është përcaktuar Zonë për shfrytëzim të përzier Banim me njësi dhe Afarizëm	Kërkesa miratohet, sepse lokacioni në cilin ndodhen parcelat tuaja ashtu sipas kërkesave tuaja për dhënjën e informatave në radhë të parë e pastaj pëlqimeve për rregullim të dokumentacionit për aprovim nga MMPHI-ja, Komuna e Obiliqit e ka paraparë destinimin e këtyre parcelave sipas kërkesës tuaj dhe poashtu në bazë të pëlqimeve të marr nga MMPHI-ja dhe duke parë interesimin e juaj që ky projekt të finalizohet në bazë të kërkesës tuaj për t'u paisur me kushte ndërtimore për ngritjen e këtij projekti madhor. Parcelat tuaja një pjesë janë parapara si Zonë me Kodin ZSHP-2-E dhe një pjesë tjetër me ZSHP-2, kështu që kërkesa aprovohet dhe ky lokacion me ZSHP-2-E do të mund të shfrytëzohet edhe si ZSHP-2.



4	Valdet Ismajli	Kërkesë për ndryshimin e destinimit të parcelave nga toka bujqësore në tokë ndërtimore	Ankesë lidhur me pronat të cilat nuk janë paraparë nga Komisioni si toka ndërtimore duke pas parasysh se kane tërë infrastrukturën, të hyjnë edhe këto në zona ndërtimore sikurse parcelat e tjera në atë zonë	Parcelat tona të parashihen si prona ndërtimore	Kërkesa refuzohet, ngase zona ku ju kërkoni të parashihet nga komisioni si tokë ndërtimore, me Planin Zhvillimor të Komunës së Obiliqit është paraparë tokë bujqësore dhe Harta Zonale rrjedh si derivat i PZHK-së. Mirëpo duhet të keni parasysh se toka bujqësore ka përparësitë e veta ku aktivitete të lejuara ndahen në: Shfrytëzimet e lejuara ku hyjnë kultivimi i bimëve, i drithërave, i pemëve, perimeve, respektivisht kultivimi i bimëve. Pastaj kemi shfrytëzimet e lejuara dytësore ku lejohen shërbimet tregtare në të mirën e bujqësisë respektivisht ngritja e objekteve montazh për kultivimin e erëzave, bimëve aromatike, farmaceutike dhe mjekësore, veprimtarit ndihmëse për prodhime bimore, veprimtari për grumbullimin bimëve pas korrjes, pemëve pas vjeljes, etj. Përveq këtyre kemi edhe shfrytëzimet e lejuara të veqanta ku hyjnë infrastruktura bujqësore si fermat, ndërtesat mbështetëse të fermave dhe objektet për grumbullimin dhe trajtimin e produkteve bujqësore, ndërtesa për përpunim, ruajtje dhe konzervim të mishit, bletari, kamping, etj.
5	Ramadan Maloku- i autorizuar JuristGuard Law Firm SHPK	Kërkesë që parcela e tij të përfshihet në Planin Urbanistik Zhvillimor të Komunës	Ankesë lidhur me mospaisjen me leje ndërtimore	Nuk është përfshirë parcela në HZK si tokë ndërtimore dhe pse nuk mund të paisem me leje ndërtimore kur ne vitin 2010 kam pasur leje ndërtimore, pasi në zonën përreth ka objekte ekzistuese	Kërkesa refuzohet, ngase zona ku ju kërkoni të parashihet nga komisioni si tokë ndërtimore, me Planin Zhvillimor të Komunës së Obiliqit është paraparë tokë bujqësore dhe Harta Zonale rrjedh si derivat i PZHK-së. Mirëpo duhet të keni parasysh se toka bujqësore ka përparësitë e veta ku aktivitete të lejuara ndahen në: Shfrytëzimet e lejuara ku hyjnë kultivimi i bimëve, i drithërave, i pemëve, perimeve, respektivisht kultivimi i bimëve. Pastaj kemi shfrytëzimet e lejuara dytësore ku lejohen shërbimet tregtare në të mirën e bujqësisë respektivisht ngritja e objekteve montazh për kultivimin e erëzave, bimëve aromatike, farmaceutike dhe mjekësore, veprimtarit ndihmëse për prodhime bimore, veprimtari për grumbullimin bimëve pas korrjes, pemëve pas vjeljes, etj. Përveq këtyre kemi edhe shfrytëzimet e lejuara të veqanta ku hyjnë infrastruktura bujqësore si fermat, ndërtesat mbështetëse të fermave dhe objektet për grumbullimin dhe trajtimin e produkteve bujqësore, ndërtesa për përpunim, ruajtje dhe konzervim të mishit, bletari, kamping, etj. Sa i përket lejes ndërtimore sipas Ligjeve të ndërtimit çdo aktvendim për leje ndërtimore ka afat brenda të cilit duhet të fillojnë ndërtimet, kështu që ju nuk e keni respektuar afatin ligjor dhe kjo leje ndërtimore është e pavlefshme. Në vitin 2010 është aprovuar PZHKU 2010-2020+ dhe parcela e juaj ka mbetur si tokë bujqësore, për këtë arsye nuk keni mundur të paiseni me leje ndërtimore.
6	Enver Gashi	Kërkesë për plotësim dhe ndryshim të destinimit të hapësirës me Kodin ZSHP-2-E	Ankesë që nuk është specifikuar shfrytëzimi I zonës me Kodin ZSHP-2-E	Të theksohet mundësia që në rast se nuk shfrytëzohet kjo hapësirë për ndërtime parkut solar e njëjta të mund të shfrytëzohet për ndërtim siq është e destinuar Zonë me shfrytëzim të përzier përkatësisht në pikën 4.1 të pjesës tekstuale në tabelën nr.10-Lista e zonave të destinuara sipas kushteve zhvillimore dhe në të cilën Hapësira me Kodin ZSHP-2-E është përcaktuar Zonë për shfrytëzim të përzier Banim me njësi dhe Afarizëm	Kërkesa miratohet, sepse lokacioni në cilin ndodhen parcelat tuaja ashtu sipas kërkesave tuaja për dhënjen e informatave në radhë të parë e pastaj pëlqimeve për rregullim të dokumentacionit për aprovim nga MMPHI-ja, Komuna e Obiliqit e ka paraparë destinimin e këtyre parcelave sipas kërkesës tuaj dhe poashtu në bazë të pëlqimeve të marr nga MMPHI-ja dhe duke parë interesimin e juaj që ky projekt të finalizohet në bazë të kërkesës tuaj për t'u paisur me kushte ndërtimore për ngritjen e këtij projekti madhor. Parcelat tuaja një pjesë janë parapara si Zonë me Kodin ZSHP-2-E dhe një pjesë tjetër me ZSHP-2, kështu që kërkesa aprovohet dhe ky lokacion me ZSHP-2-E do të mund të shfrytëzohet edhe si ZSHP-2.



7	Florim Tovërlani	Kërkesë që të përfshihet e tërë parcela në tokë ndërtimore	Ankesë lidhur me mospërfshirjen e komplet parcelës në Hartë Zonale	Probleme me kufijte e parcelës, mos definim i kuartit i vijave të parcelës.	Kërkesa juaj refuzohet, grupi punues nuk është përgjegjës për definimin e vijave të parcelës, pjesët rreth rrugës janë përfshirë si zona ndërtimore dhe nuk mund të përfshihen të tëra parcelat në zona ndërtimore, sepse duhet të respektohet proporcioni i destinimit të zonave ashtu siç është paraparë me PZHK.
8	Shpresim Prestreshi	Kërkesë që parcelat të përfshihen në zonë ndërtimore për shkak të interesimit të investitorëve për ndërtim	Të merret parasysh shqetësimi im lidhur me destinimin e parcelave të mija në draftin e HZK-së	Propozimin tim e bazoj mbi rritjen dhe nevojën e bizneseve për tokë në Komunën tonë	Kërkesa refuzohet, e ky refuzim i drejtohet parcelave me nr.00031K-0 dhe parcela nr.00056K-0 sipas HZK-janë të parapara për bujqësi, sepse ky destinim është i përcaktuar nga PZHK-ja dhe kjo nuk mund të jetë ndryshe, sepse HZK-ja është produkt i PZHK-së, kurse parcelat me nr.00263-0 dhe parcela 00264-0 janë të parapara për ndërtim, sepse ashtu edhe është gjendja faktike e mbushur me ndërtime.
9	Ismet Konushevc	Kërkesë për shëndrrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore	Të merret parasysh kërkesa lidhur me paisjen me leje ndërtimore në parcelën me nr.00849-0 në Milloshevë	Propozimin tim e bazoj mbi rritjen dhe nevojën e bizneseve për tokë në Komunën tonë	Kërkesa refuzohet, sepse destinimi i kësaj parcele me Planin Zhvillimor të Komunës së Obiliqit 2023-2031 është tokë bujqësore.

T'i dorëzohet:

- Kryetarit të Komunës
- Drejtorisë së DPUPK-së
- anëtarëve të komisionit
- palëve
- në arkiv

Data 25.09.2024 Obiliq

Komisioni për shqyrtimin e ankesave:

1.Arben Berisha-kryetar i komisionit

2.Vlora Halimi –anëtare

3.Hamit Mjeku –anëtar

4.Eugen Mehmeti –anëtar

5.Valbona Preniqi –anëtar

6.Valmira Ibrahimit –anëtar

7.Zorica Spasiq –anëtar

The image shows seven handwritten signatures in blue ink, each corresponding to a member of the commission listed on the left. To the right of the signatures is a large blue circular official stamp. The stamp contains the text 'REPUBLIKA E KOSOVES' at the top, 'KOMUNA E OBILIQIT' in the middle, and 'OBILIQ - OBILIQ' at the bottom. In the center of the stamp is a shield with a star and crescent, and the number '5' is visible below the shield.

A small blue circular official stamp, similar to the larger one, located at the bottom right of the page. It contains the text 'REPUBLIKA E KOSOVES' and 'KOMUNA E OBILIQIT'.